



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS
KOSOVO BASKETBALL FEDERATION
KOŠARKAŠKI SAVEZ KOSOVA

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR DHE PASQYRAT FINANCIARE

Me dhe për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020



Përmbajtja

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR.....	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR.....	5
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE.....	6
PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE	7
PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË	8
1. Hyrje.....	9
2. Politikat e kontabilitetit	10
3. Llogaritë e Arkëtueshme.....	11
4. Parapagimet	11
5. Paraja dhe ekuivalentët e saj	11
6. Llogaritë e Pagueshme	12
7. Pagat dhe tatimet e pagueshme.....	12
8. Të hyrat	13
9. Shpenzimet e Pagave	13
10. Shpenzime operative	14
11. Detyrimet kontingjente dhe zotimet	15
12. Ngjarjet pasuese	15

ASK
ASK
ASK
BASICIBALL FEE
*PR
PR
PRI

RAPORT I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: Bordin e Federatës së Basketbollit të Kosovës ("FBK")

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare FBK në Kosovë ('Organizata'), të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2020 dhe pasqyra e të ardhurave, për vitin që përfundoi në atë datë, dhe shënimet e pasqyrave financiare, përfshirë politikat domethënëse të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të Organizatës për vitin që përfundoi me 31 dhjetor 2020 janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kërkesat për raportim financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë.

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin në pajtueshmëri me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar më tutje në seksionin *Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare* e këtij raporti.

Ne jemi të pavarur nga organizata në pajtueshmëri me kërkesat etike që janë relevante gjatë auditimit tonë të pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike në pajtueshmëri me këto kërkesa. Ne besojmë se evidencat e përfuara të auditimit janë të majftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me dispozitat e raportimit financiar të organizatës dhe ligjeve relevante në Kosovë dhe për kontrole të tilla të cilat menaxhmenti përcakton se janë të domosdoshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së organizatës të vijojë sipas hipotezës së vijimësisë, duke shpalosur, nëse është e zbatueshme, çështjet lidhur me hipotezën e vijimësisë dhe duke përdorur bazën e kontabilitetit bazuar në vijimësi përveç nëse menaxhmenti ka për qëllim të likujdohë ose të ndërpresë aktivitetet e organizatës, ose nuk ka ndonjë alternativë tjetër përveç të veprojnë në këtë mënyrë. Personat e ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikqyrjen e procesit të raportimit financiar të organizatës.

Përgjegjësitë e auditorit në auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë të përftojme siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të japim një raport të auditorit që përfshinë opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është nivel i lartë i sigurisë, por nuk është garancion se auditimi i kryer sipas SNA gjithmonë do të zbulojë anomali materiale kur ekzistojnë ato. Anomali mund të paraqiten nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen që janë materiale nëse, individualisht ose të grumbulluara, ato mund të ndikojnë në mënyrë të arsyeshme në vendimin që marrin përdoruesit bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e auditimit në pajtueshmëri me SNA, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional përgjatë tërë auditimit.

Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, projektojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit si përgjigje ndaj këtyre rreziqeve dhe përftojme evidenca të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të na ofruar bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të anomalive materiale për shkak të mashtrimit është më i lartë se ai i shkaktuar nga gabimet, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjet e fshehta, falsifikimin, lënjen anash me qëllim, keqinterpretimin ose anashkalimin e kontrolleve.
- Përftojme njohuri mbi kontrollet e brendshme që janë relevante për auditimin në mënyrë që të projektojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme për ato rrethana, por jo me qëllim të japim një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të kompanisë.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe shpalosjeve përkatëse nga menaxhmenti.
- Përfundojmë mbi përshtatshmërinë e përdorimit të hipotezës së vijimësisë nga ana e menaxhmentit dhe bazuar nga evidenca e përftuar e auditimi, nëse ekziston ndonjë pasiguri materiale lidhur me ngjarjet ose kushtet që mund të hedhin dyshim domethënës mbi aftësinë e kompanisë për të vijuar ekzistencën. Nëse arrijmë në përfundim se ekziston një pasiguri materiale, nga ne kërkohet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditorit në shpalosjen përkatëse të pasqyrave financiare ose, nëse një shpalosje e tillë është e pamjaftueshme, ta modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të përfthuara deri në datën e raportit të auditorit. Mirëpo, ngjarjet dhe kushtet e ardhshme mund të shkaktojnë që kompania të mos vijojë aktivitetet e saj.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, në mes tjerash edhe lidhur me fushëveprimin e planifikuar, kohën e auditimit dhe gjetjet domethënës të auditimit, përfshirë çfardo mangësi domethënës në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

Lulzim Krasnqi
Auditor ligjor

Quatra Audit Int. L.L.C.
04 mars 2021



A.F.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK

PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR


Me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat në Euro

Me 31 dhjetor		<u>2020</u>	<u>2019</u>
Asetet	<i>Shënimet</i>		
Asetet jo-qarkulluese			
Pajisjet dhe makinat		-	-
Total asetet jo-qarkulluese		<u>-</u>	<u>-</u>
Asetet qarkulluese			
Llogaritë e arketushme	3	158,220	91,038
Parapagime	4	3,812	948
Paraja	5	16,318	33,585
Total asetet qarkulluese		<u>178,350</u>	<u>125,571</u>
Total Asetet		<u>178,350</u>	<u>125,571</u>
Detyrimet dhe fondi			
Fondi			
Bilanci i fondeve me 01 Janar		(266,220)	44,127
Teprica / (Deficiti) nga pasqyrat e të ardhurave		159,618	(310,347)
Totali i fondeve		<u>(106,602)</u>	<u>(266,220)</u>
Detyrimet afatshkurta			
Llogaritë e pagueshme	6	270,479	386,635
Pagat dhe tatimet e pagueshme	7	14,473	5,156
Total i detyrimeve afatshkurta		<u>284,952</u>	<u>391,791</u>
Totali i detyrimeve dhe bilanci i fondit		<u>178,350</u>	<u>125,571</u>

Aprovuar nga:

Arben Fetahu, Kryetar




Shënimet e bashkëngjitura në faqet 9 deri 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

**FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK
PASQYRA E TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat në Euro

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		<u>2020</u>	<u>2019</u>
	<i>Shënimet</i>		
Të hyrat			
Të hyrat	8	632,976	934,763
Totali i të hyrave		<u>632,976</u>	<u>934,763</u>
Shpenzimet			
Pagat e Stafit, Trajnerëve, Referëve dhe të tjera	9	(210,220)	(189,799)
Operative dhe Administrative	10	(263,138)	(1,055,311)
Totali i shpenzimeve		<u>(473,358)</u>	<u>(1,245,110)</u>
Teprica (humbja)		<u><u>159,618</u></u>	<u><u>(310,347)</u></u>

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 9 deri 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK
PASQYRA E BILANCIT TË FONDEVE

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat në Euro

	Bilanci i fondeve	Gjithsej
Më 31 dhjetor 2018	44,127	44,127
Fitimi / (humbja) i/e vitit	(310,347)	(310,347)
Më 31 dhjetor 2019	(266,220)	(266,220)
Fitimi / (humbja) i/e vitit	159,618	159,618
Më 31 dhjetor 2020	(106,602)	(106,602)

Shënimet e bashkëngjitura në faqet 9 deri 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS - FBK

PASQYRA E RRJEDHJES SË PARASË

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat në Euro

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor		2020	2019
	<i>Shënimi</i>		
I. Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative			
Teprica (humbja)	<i>PAGJ</i>	159,618	(310,347)
<i>Korigjuar për transaksionet jo monetare:</i>			
Shpenzimet e zhvlerësimit		-	
		159,618	(310,347)
Lëvizjet në kapitalin qarkullues			
(Rritja)/Zvogëlimi në të arkëtueshme	<i>3</i>	(67,181)	(91,039)
(Rritja)/Zvogëlimi në avanset e dhëna	<i>4</i>	(2,864)	(948)
Rritja/(Zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme dhe të tjera	<i>6</i>	(116,156)	386,635
Rritja/(Zvogëlimi) në tatime dhe paga të pagueshme	<i>7</i>	9,317	5,156
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative (I)		(17,267)	(10,542)
II. Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese			
Blerja / shitja e pasurive joqarkulluese			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese (II)		-	-
III. Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese			
Rritja/(Zvogëlimi) huamarrjeve			
Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese (III)		-	-
IV. Rritja neto në para dhe ekuivalente (I + II + III)		(17,267)	(10,542)
V. Paraja në fillim të vitit/periudhës	<i>5</i>	33,585	44,127
VI. Paraja në fillim të vitit/periudhës (IV + V)	<i>5</i>	16,318	33,584



Shënimet e bashkëngjitura në faqet 9 deri 14 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat në Euro

1. Hyrje

Federata e Basketbollit e Kosovës është asociacion vullnetar i pavarur i klubeve dhe shoqatave të themeluara nga qytetarët, me qëllim të interesave të veçanta dhe të përbashkëta në lëmin e sportit të basketbollit.

Federata e Basketbollit e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Federata) është institucioni më i lartë i sportit të basketbollit në Kosovë për meshkuj dhe femra, që për veprimtari themelore e ka sportin e basketbollit, e organizuar në pajtueshmëri me dispozitat e Ligjit për Sport e Kosovës.

Federata është subjekt juridik dhe vepron në pajtim me Statutin, Statutin dhe Rregulloret e FIBA-s, Ligjin për Sportin e Kosovës dhe Ligjin mbi organizatat jo fitimprurëse.

Federata, si organizatë jo fitimprurëse është e regjistruar në organin përgjegjës dhe e licencuar në Ministrinë për Kulturë, Rini dhe Sport të Kosovës (Departamenti i Sportit).

Qëllimet e Federatës janë:

- Masovizimi, zhvillimi cilësor dhe organizimi i basketbollit në Kosovë.
- Sigurimi dhe realizimi i të gjitha kushteve për veprimtarinë e seleksioneve të Federatës.
- Organizimi dhe avancimi profesional i lojtarëve, trajnerëve, gjyqtarëve dhe vëzhguesve të basketbollit.
- Ndihma organizatave të tjera në promovimin e basketbollit në të gjitha fushëveprimet e sportit të basketbollit, në përputhje me aktet normative.
- Përcaktimi i sistemit të garave për të gjitha kategoritë në nivel të Federatës.
- Pjesëmarrja në manifestime dhe gara ndërkombëtare.
- Mbështetja e zhvillimit të basketbollit në vise të pazhvilluara të Kosovës.
- Organizimi i të gjitha garave në nivel të Kosovës, siç janë: Ligat, Kupa dhe turnetë.
- Organizimi i aktiviteteve profesionale vendore dhe ndërkombëtare.
- Organizimi i kampeve, seminareve, publikimeve profesionale etj.
- Sigurimi i bazës materiale për sportin e basketbollit nëpërmjet marketingut, aktiviteteve ekonomike me qëllim të përmbushjes të kërkesave për veprimtarinë e Federatës
- Përcaktimi i parimeve themelore mbi definimin e statusit të gjithë subjekteve në kuadër të Federatës.
- Pjesëmarrja në punën e KOK-ut dhe asociacioneve të tjera sportive.
- Veprimi kundër përdorimit të dopingut, në përputhje me vendimet e KOK-ut dhe FIBA-s.
- Pjesëmarrja në punën e organizatave të tjera sportive ndërkombëtare, të cilat janë të lidhura me sportin e basketbollit.

Anëtarët e Federatës janë: Klubet e basketbollit (publik edhe private), Shoqata e trajnerëve, Shoqata e gjyqtarëve (organizata profesionale të Federatës), dhe të gjitha klubet dhe shoqatat e tjera të cilat pranohen dhe licencohen në Federatë.

Çdo anëtar i Federatës duhet ta paguajë anëtarësinë vjetore, të cilën e cakton Kuvendi

Organet e Federatës janë:

- Kuvendi
- Bordi
- Kryetari
- Këshilli Mbikëqyrës

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat në Euro

2. Politikat e kontabilitetit

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adaptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare:

2.1 Bazat e përgatitjes

Për qëllime të raportimit financiar për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020, FBK përdor bazën akruale të kontabilitetit sipas së cilës të hyrat dhe shpenzimet njihen në momentin kur ndodhin.

2.2 Transaksionet në valuta të huaja

Transaksionet në valuta të huaja janë të shndërruara në vlerën monetare raportuese duke përdorur shkallën aktuale të këmbimit të transaksionit. Fitimi dhe humbja si rezultat i transaksioneve nga shëndrrimi në normat e këmbimit të fund- vitit të mjeteve monetare dhe detyrimeve në valutat e huaja janë të njohura në pasqyrën e të ardhurave.

2.3 Prona, impijantet dhe paisjet

Meqë Federata nuk posedon me pasuri te paprekshme, ajo në të njëjtën kohë nuk ka aplikuar ndonjë sistem të vlerësimit dhe regjistrimit të tyre e kosnektivisht edhe të zhvlerësimit të tyre.

2.4 Asetet Financiare

Asetet Financiare klasifikohen në kategoritë e specifikuara vijuese: mjetet financiare në vlerën reale përmes fitimit apo humbjes, kreditë dhe të arkëtueshmet, mallrat e gatshmet për shitje. Klasifikimi varet nga natyra dhe qëllimi i mjeteve financiare që janë përvetsuar. Menaxhmenti e përcakton klasifikimin e mjeteve financiare në njohjen fillestare. Deri në datën e bilancit të gjendjes FBK nuk ka asetë të klasifikuara në kategoritë e vlerës fer përmes Fitimit apo Humbjes asetëve të gatshme për shitje.

2.5 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë mbahen në bilancin e gjendjes sipas kostos. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në dorë dhe depozitat e mbajtura në bankë të pa afatizuara.

10/2019

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK
Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019
Të gjitha shumat në Euro

3. Llogaritë e Arkëtueshme

Me 31 dhjetor	2020	2019
Të hyrat nga klubet	69,856	25,341
MKRS - TM4	63,366	62,118
Projekti FIBA 3x3	-	3,580
Reload	5,000	-
Art Motion	20,000	-
Total	158,221	91,039

Në llogaritë e arkëtueshme janë të përfshira borxhet nga klubet e basketbollit për të hyrat e paarkëtuara gjatë vitit 2019 dhe 2020, me vendim të bordit të datës 30 korrik 2020 për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid19, bordi ka marrë vendim që të gjitha obligimet e klubeve ndaj FBK-së t'i "ngrijë" deri në datën e regjistrimit të tyre për licencimin e garave 2021-2022.

4. Parapagimet

Parapagimet përbëjnë paranë e dhënë avans për shërbimet që pritet të i marr nga gjatë vitit pasues, saldo me 31 dhjetor 2020 ishte 3,812 Eur (2019: 948 Eur).

5. Paraja dhe ekuivalentët e saj

Me 31 dhjetor	2019	2019
TEB Bank	14,537	33,455
Paraja në arkë	1,782	130
Total	16,318	33,585



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK
Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019
 Të gjitha shumat në Euro

6. Llogaritë e Pagueshme

Llogaritë e pageshme paraqesin borxhet që i ka Federata në fund të vitit 31 dhjetor 2020.

Me 31 dhjetor	2019	2019
Albtours Vas Tour Operator shpk	10,000	43,978
Dafi Compani Shpk	40,522	42,618
Emerald Hotel	2,000	19,694
FAME Shpk	30,904	35,821
Hotel International Prishtina	35,000	38,633
Hotel Sirius	-	26,304
Mada Group Shpk	10,001	23,799
Mobi Shop Mani - Nokia N.T.P.	-	2,144
NTSh Rozafa	-	8,779
Sporting	15,626	75,855
Taunita NPH	10,000	17,384
Venus Shpk	-	9,158
Tjera	16,772	25,692
Shpenzimet akruale	34,050	
Detyrimet ndaj klubeve	49,250	
Nën-totali	254,123	369,858
Starcard	1,356	827
Huazimet e marra	15,000	15,950
Total	270,479	386,635

7. Pagat dhe tatimet e pageshme

Me 31 dhjetor	2020	2019
Tatimi ne qira	914	89
Tatimi ne paga	2,875	435
Kontributet pensionale	3,934	681
Pagat e pagushme	-	2,302
Qiraja e pagushme	6,750	1,800
Total	14,473	5,306



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK**Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

*Të gjitha shumat në Euro***8. Të hyrat**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2020	2019
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	253,462	443,270
FIBA	117,868	75,163
Nën-total (I)	371,330	518,433
II. Të hyrat nga donatorët		
Të hyrat nga TEB	50,000	27,000
Art Motion	40,000	-
IP-Kos	35,000	3,000
Vitaminka	12,000	17,000
Fabrika amortizatoreve	10,000	30,000
Të hyra nga Reload	5,000	-
Genius Sports	1,000	-
Kerasan Prishtina	-	1,500
Kosovo Sports and Envoy	-	14,668
Nën-total (II)	153,000	93,168
III. Të hyrat nga aktivitetet		
Të hyrat nga aktivitetet	96,605	67,477
Të tjera	12,041	48,147
Te hyrat nga kampionati evropian	-	196,538
Komuna e Prishtines	-	11,000
Nën-total (III)	108,646	323,162
Gjithsej Të hyrat (I+II+III)	632,976	934,763

9. Shpenzimet e Pagave

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2020	2019
Shpenzimet për paga Refer/Vëzhgues etj	129,840	110,470
Shpenzimet për paga e stafit të FBK	68,765	70,303
Kontributet	11,615	9,026
Gjithsej	210,220	189,799

BOLL
AVE
ATION
FBK
STINA
STINT
HTIN

A.F

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK**Shënimet e Pasqyrave Financiare**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

*Të gjitha shumat në Euro***10. Shpenzime operative**

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor	2020	2019
Përfaqësuesja Seniore (Meditje, Paga Trajnerit etj)	71,669	97,853
Shpenzimet për udhëtime dhe takime zyrtare	61,084	404,523
Regjistrimi I lojtareve te huaj FIBA	19,861	8,990
Transport	12,951	47,131
Shpenzimet për zyre	12,889	24,744
Shpenzime të tjera	11,499	170,097
Qiraja	11,256	11,868
Konsulencë	9,204	5,232
Ushqim për lojtarët dhe stafin e Përfaqësuesve	7,874	80,720
Marketing	7,155	30,577
Pajisje zyrtare (logo, topa etj)	6,033	56,595
Donacion	4,400	-
Shpenzimet për trajnime dhe seminare	4,340	-
Rryma, Uji	4,333	5,505
Shpenzimet për ndihmë klubeve	4,000	27,017
Shpenzimet e testeve per Covid	3,195	-
Shpenzimet e telekomunikimit dhe TI	2,532	8,423
Fotograf dhe DJ	2,419	7,268
Shërbime mjekësore	1,588	13,607
Makina me qira	1,235	2,660
Medikamente	751	2,509
Mirembajtje dhe rregullime të hapësirave sportive	699	35,147
Sigurime tjera gjate Kampionatit	680	9,455
Shpenzime per Licenca	680	-
Membership	530	-
Permbarimi	282	-
Banesa me qira per Lojtarët	-	3,775
Sigurime Shendetsore	-	1,614
Gjithsej Shpenzimet Tjera	263,138	957,458

Në shpenzimet për ndihmë klubeve është e përfshirë një vlerë prej 4,000 Euro e cila është dhënë si subvencion klubeve, duke u ndërlidhur me vendimin e Qeverisë së Republikës Kosovës e cila i ka subvencionuar këto të fundit me gjithësej 140,000 Euro nga buxheti i paskos emergjente.

Në shpenzimet operative janë të përfshira 71,145 Euro të cilat i përkasin periudhës 2019 mirëpo janë njohur si shpenzime gjatë vitit 2020 për shkak të ndryshimit të metodës së regjistrimeve të transaksioneve në kontabilitet nga baza e keshit në baza akruale. Këto shpenzime i përkasin shpenzimeve për referë, trajner, fotograf etj.



A.F.

FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS – FBK

Shënimet e Pasqyrave Financiare

Për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019

Të gjitha shumat në Euro

11. Detyrimet kontingjente dhe zotimet

Me 31 dhjetor 2020 nuk ka ndonjë detyrim kontingjent që kërkon shpalosje në pasqyrat financiare të organizatës (me 31 dhjetor 2019: zero).

Çështjet gjyqësore

Me 31 dhjetor 2020 dhe 2019, Organizata nuk ka pasur ndonjë çështje gjyqësore të hapur.

Zotimet e qirasë operative:

	Me 31 dhjetor 2020	Me 31 dhjetor 2019
Pagesa brenda një viti	13,300	11,772
Pagesa më shumë se një vit ose më pak se pesë vite	-	-

12. Ngjarjet pasuese

Në Dhjetor 2019, shpërtheu një lloji i ri i koronavirusit, COVID-19, dhe brenda disa javësh, megjithë përpjekjet për të mbajtur virusin e izoluar, ai u përhap dhe kjo pati një ndikim në mbylljen e qyteteve dhe bizneseve globalisht dhe numri i të infektuar u rritë ndjeshëm, përfshirë këtu edhe Kosovën. Më 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli situatë pandemie për shkak të emergjencës globale të shkaktuar nga shpërthimi i COVID19. Përhapja e koronavirusit ende po evolon dhe efektet e saj mbeten të panjohura.

Nuk ka ngjarje të rëndësishme pasuese pas datës së raportimit që kërkon ndonjë rregullim ose shpalosje në këto pasqyra financiare